L I G J
Nr.8144, datë 11.9.1996

PËR MIRATIMIN ME DISA SHTESA E NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1579, DATË 13.8.1996 "PËR NDËRTIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 16 e 28 pika 19 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me disa shtesa e ndryshime dekreti nr.1579, datë 13.8.1996 me titullin:"Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ndryshimet përkatëse në ligjet e zgjedhjeve" dhe me përmbajtjen e plotë si më poshtë:

"- Neni 1:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë është organ përhershëm, i cili organizon, drejton dhe kontrollon zhvillimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore elektorale të shtetit shqiptar.

Në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, si dhe me dispozitat e ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës dhe përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë.

- Neni 2:

Propozimet për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i dërgohen Presidentit të Republikës nga Këshilli i Ministrave dhe partitë politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 7- vjeçare. Anëtarët e tij gëzojnë të drejtën e riemërimit.

- Neni 3:

Kryetari dhe Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve propozohen nga Këshilli i Ministrave. Kryetari dhe zëvendëskryetari propozohen nga rradhët e personelit shkencor universitar.

Zëvendëskryetari gëzon pozitë juridike të barabartë me kryetarin dhe është përfaqësues i partisë më të madhe opozitare. Në rast se kjo parti nuk paraqet kandidaturë për zëvendëskryetar, atëherë ky vend i jepet partisë vijuese opozitare.

Sekretar i Komisionit është drejtuesi i Drejtorisë së Organizimit të Zgjedhjeve dhe Referendumeve në Sekretariatin e Shtetit për Pushtetin Lokal.

Vendet e anëtarëve të Komisionit ndahen në mënyrë të barabartë midis partive politike pjesëtare të koalicionit qeveritar dhe të opozitës. Brenda këtyre ndarjeve, vendet në Komision zihen nga përfaqësuesit e partive politike në përpjesëtim me rezultatet e arritura prej tyre në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal.

- Neni 4:

Në rast se partia politike që bën pjesë në grupin e koalicionit qeveritar ose të opozitës, largohet nga ky grup, atëherë edhe vendi ose vendet që i takojnë asaj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve rishpërndahen brenda grupimit përkatës në përputhje me kriterin e vendosur në paragrafin 4 të nenit 3. Në rast se kjo parti ka arritur rezultate më të larta në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal sesa ndonjëra nga partitë e grupit në të cilin ajo hyn dhe që kanë përfaqësues në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, atëherë partisë që largohet nga grupimi përkatës i garantohet vendi i anëtarit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që i përket partisë që ka arritur rezultate më të ulta në këto zgjedhje.

Pas përfundimit të zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal, raportet e përfaqësimit të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndryshojnë në përputhje me rezultatet e arritura prej tyre në këto zgjedhje.

Ndryshimet në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk mund të bëhen në 15 ditët e fundit përpara fillimit të zgjedhjeve.

- Neni 5:

Kur partia politike, të cilës i takojnë vende në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nuk paraqet kandidatura për zënien e këtyre vendeve, atëherë vendet e caktuara për të zihen nga kandidatët e propozuar nga partitë e tjera politike sipas rradhës së përcaktuar në bazë të kritereve të paragrafit 4 të nenit 3, jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve.

- Neni 6:

Në nenin 35 të ligjit nr. 7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8055, datë 1.2.1996, bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë hiqen fjalët " ... që kanë paraqitur lista elektorale për ndarjen e mandateve shtesë, jo më vonë se 45 ditë përpara ditës së zgjedhjeve."

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon: "Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues pranë tij, që nga data e fillimit të fushatës së zgjedhjeve e deri në përfundim të tyre."

- Neni 7:

Në fjalinë e parë të nenit 46 të ligjit nr. 7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8055, datë 1.2.1996, hiqen fjalët "... në Komisionin Qendror apo ...".

- Neni 8:

Në nenin 29 të ligjit nr. 7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal" bëhen këto ndryshime :

1. Në paragrafin e dytë hiqen fjalët: " ... jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve."

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon :

"Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues pranë tij, që nga data e fillimit të fushatës së zgjedhjeve e deri në përfundim të tyre."

- Neni 9:

Në paragrafin 1 të nenit 36 të ligjit nr. 7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal" hiqen fjalët "... në Komisionin Qendror apo ...".

- Neni 10:

Dekreti nr. 1568, datë 2.8.1996 "Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 11:

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më datën 11.9.1996.

Shpallur me dekretin nr.1605, datë 17.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha